



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 70 Prot

Tiranë, më 31, 05, 2013

VENDIM Nr. 258, dt. 31.05.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë me pjesëmarrjen dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apolloni, në mbledhjen e datës 31.05.2013, mbasi shqyrtoi propozimin e misionit arkeologjik shqiptaro-gjerman mbi masat konservuese pas rrëshqitjeve të ndodhura në Teatrin Antik të Apollonisë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë në parim propozimin për masat konservuese në Teatrin Antik të Apollonisë si pasojë e rrëshqitjeve, bazuar në propozimin e misionit arkeologjik shqiptaro-gjerman.
- II. Të përgatitet studimi gjeologjik duke realizuar sondazhe gjeologjike jo vetëm në zonën e rrëshqitjes, por edhe në të dy anët që e kufizojnë atë.
- III. Projekti përfundimtar i zbatimit të përgatitet në përputhje me studimin gjeologjik të hartuar mbi bazën e rezultateve të sondazheve gjeologjike.
- IV. Gjatë hartimit dhe zbatimi të projektit të merren në konsideratë të gjitha rekomandimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhënë nëpërmjet oponencës teknike zyrtare.



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
www.asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- V. Ndërhyrjet për stabilizimin e situatës në Teatrin Antik të Apollonisë duhet të përfundojnë brenda vitit 2013.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

VISAR ZHITI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI

